

Ian Buruma  
Avishai Margalit

# OKSIDENTALIZMI PERËNDIMI DHE ARMIQTË E TIJ

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

LUFTA KUNDËR PERËNDIMIT .....	7
QYTETI PERËNDIMOR .....	17
HERONJ DHE TREGTARË .....	49
MENDJA E PERËNDIMIT .....	71
MËRIA HYJNORE .....	92
FARAT E REVOLUCIONIT .....	123

## LUFTA KUNDËR PERËNDIMIT

Në korrik të vitit 1942, saktësisht shtatë muaj pas bombardimit të flotës amerikane në Pearl Harbor dhe pasi Japonia kishte shkatërruar forcat perëndimore në Azinë Juglindore, studiues dhe intelektualë të shquar japonezë u mbledhën në qytetin e Kiotos për një konferencë. Disa prej tyre qenë shkrimtarë, pjesë e të ashtuquajturit Grupi Romantik; të tjerë filozofë të shkollës budiste-hegeliane të Kiotos. Tema për të cilën u mbledhën të debatonin, ishte “Si të shporrim modernitetin”<sup>1</sup>

Ishte koha kur mbizotëronte zelli nacionalist dhe intelektualët e pranishëm në këtë konferencë, në një mënyrë a një tjetër, ishin që të gjithë nacionalistë, por megjithatë, çuditërisht, aty s'u përmend thajse fare lufta që po zhvillohej atë kohë në Kinë, në Havai, apo dhe në Azinë juglindore. Një nga pjesëmarrësit, Hayashi Fusao, ish marksist i kthyer në një nacionalist të bindur, më pas shkruante se sulmi kundër Perëndimit e kishte mbushur me gëzim. Lajmi i kishte ardhur kur ai vetë gjendej në Mançurinë akull të ftohtë, por megjithatë, ai pati përshtypjen sikur atë çast retë e zeza qenë shpërndanë, për t'ia lënë vendin një qielli të kaltër veror. Shumë nga kolegët e tij me siguri, provonin të njëjtën gjë. Sidoqoftë, qëllimi primar i konferencës s'që që t'i shërbente propagandës ushtarake. Ata njerëz, shkrimtarë romantikë apo filozofë, kishin kohë, që përpara se të ndodhte sulmi ndaj Pearl Harbour-it, që ia bënin vetes pyetjen se si t'ia bënin për të hequr qafesh modernitetin. Përfundimet e tyre, për aq mund të kishin koherencën e duhur për të luajtur një rol politikisht, mbështesnin propagandën në favor të një rendi të ri aziatik, nën udhëheqjen japoneze, por vetë këta intelektualë do të tmerroheshin sikur t'i akuzonin se qenë duke bërë propagandë. Ata e konsideronin veten si mendimtarë dhe jo si vegla.

Sido që të jetë, koncepti "modernitet" është një koncept i vështirë për t'u përkufizuar. Megjithatë, në Kioto e vitit 1942, ashtu si dhe në Kabul apo Karacin e vitit 2001, ai është sinonim me Perëndim. Por njëkohësisht, vetë Perëndimi është gjithashtu një koncept po aq delikat për t'u përkufizuar, sa dhe moderniteti. S'ka dyshim se intelektualët japonezë e ndjenin veten mjaft të acaruar me diçka, por nga ana tjetër, e kishin disi të vështirë të përcaktonin përse bëhej fjalë. Për njërin prej tyre, oksidentalizimi mund të krahasohej me një sëmundje që kishte prekur shpirtin japonez. Për një tjetër, "gjëja moderne" që "diçka europiane". Në konferencë u fol gjithashtu gjerësisht për pasojat e dëmshme që sillte specializimi i dijeve, i cili shkaktonte copëzimin e unitetit të kulturës shpirtërore orientale. Fajin për këtë e kishte shkencën, si dhe kapitalizmi, vërshimi në shoqërinë japoneze të teknologjisë moderne si dhe i nocioneve të lirisë individuale dhe të demokracisë. Të gjitha këto duheshin "hequr qafesh". Një kritik filmi i quajtur Tsumura Hideo, në fjalën e tij fshikulloi filmat e Hollivudit, duke ngritur lart filmat dokumentarë të Leni Riefenstahl, kushtuar mitingjeve naziste, që i afroreshin idesë që ai kishte për mënyrën sesi mund të farkëtohej një bashkësi e fortë kombëtare. Sipas pikëpamjes së tij, lufta kundër Perëndimit që një luftë kundër "qytetërimit të dëmshëm materialist, të ngritur në sajë të fuqisë financiare të kapitalizmit çifut". Që të gjithë ranë në një mendje se kultura, domethënë kultura tradicionale japoneze, që shpirtërore dhe e thellë, ndërkohë që qytetërimi modern perëndimor që sipërfaqësor dhe s'kish asnjë vlerë dhe shkatërronte çdo lloj vullneti krijues. Perëndimi, dhe sidomos Shtetet e Bashkuara, karakterizoheshin nga ftohtësia mekanike. Nëse vendet lindore, të pasura në tradita dhe me prirje holistike, do të bashkoheshin nën udhëheqjen hyjnore të Japonisë perandorake, atëherë kjo bashkësi e ngrohtë organike, do të kish mundësi të rifitonte shëndetin e vet shpirtëror. Siç u shpreh një nga pjesëmarrësit, në këtë luftë qenë përballë njëri-tjetrit gjaku japonez dhe intelektu perëndimor.

Nga ana tjetër, për aziatikët e asaj kohe dhe, deri në një farë mase, edhe për ata të sotmit, me Perëndimin nënkuptohej kolonializmi. Që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, kur Kina u poshtërua gjatë luftës së opiumit, japonezët e arsimuar e kishin kuptuar se mbijetesa e vendit të tyre varej nga studimi dhe imitimi i kujdesshëm i ideve dhe teknologjisë që i jepnin përparësi fuqive koloniale perëndimore. Asnjë komb tjetër më parë s'kishte vënë ndonjëherë në jetë një program të tillë shndërrimesh radikale, si ai i ndërmarrë nga Japonia mes viteve 1850 dhe 1910. Slogani kryesor i periudhës Meiji (1868-1912), që *Bunmei Kaika*, që do të thotë Qytetërim dhe Iluminizëm, me të cilat kuptohej pikërisht, qytetërimi dhe iluminizmi perëndimor. Intelektualët japonezë thithnin të etur gjithçka që ishte perëndimore, që nga shkencat e natyrës deri tek letërsia realiste. Mënyra e veshjes europiane, e drejta kushtetuese prusiane, strategjitë detare britanike, filozofia gjermane, kinemaja amerikane, arkitektura franceze, e mjaft gjëra të tjera që u adaptuan dhe u përshtatën.

Ky transformim u kurorëzua me sukses. Japonia jo vetëm që i shpëtoi kolonizimit, por shpejt ajo u bë një fuqi e madhe e aftë që, në vitin 1905, të mundte Rusinë në një luftë krejtësisht moderne. Tolstoi e përshkruan fitoren japoneze si triumfin e materializmit perëndimor ndaj shpirtit oriental rus. Por e gjithë kjo kishte një çmim: revolucionin industrial japonez, i cili ndodhi jo shumë kohë pas atij gjerman, duke provokuar pasoja sociale po aq shkatërrimtare. Një numër i madh fshatarësh të varfëruar u vendosën nëpër qytete, ku kushtet e jetesës qenë shpesh të frikshme. Për të rinjtë e ardhur nga fshati, të cilët shpesh qenë të detyruar të shisnin

motrat e tyre në bordellot e qyteteve të mëdha, ushtria përbënte shpesh një strehë brutale. Por, përtej problemeve ekonomike, mjaft intelektualë japonezë kishin dhe një arsye tjetër përse kërkonin të zhbënin oksidentalizimin masiv që kish ndodhur në shoqërinë japoneze gjatë fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Dukej sikur Japonia po vuante nga indigjestionin intelektual. Ajo e kishte gëlltitur tepër shpejt qytetërimin perëndimor. Dhe kjo qe pjesërisht arsyeja përse intelektualët e mbledhur në Kioto, që të reflektonin për të gjetur një mënyrë sesi të ndryshonin rrjedhën e historisë, duke hequr qafesh Perëndimin dhe duke qenë modernë nëpërmjet rikthimit të një e shkuar shpirtërore e idealizuar.

Të gjitha këto s'do të kishin interes tjetër veç atij historik, nëse ideale të tillë s'do të vazhdonin të ngjallnin ende entuziazëm. Por ja që s'është ashtu. Urrejtja për çdo gjë që lidhet me Perëndimin, simbolizuar nga Amerika, vazhdon të mbetet e fortë, ndonëse sot vendi tipik i kësaj s'është më Japonia. Është kjo urrejtje që i shtyn myslimanët radikalë drejt një ideologjie islamike të politizuar, për të cilën Shtetet e Bashkuara janë mishërimi i djallit. Të njëjtën gjë provojnë nacionalistët më ekstremë në Kinë, të njëjtën gjë gjen në rajone të tjerë të botës jo-perëndimore. Gjurmë të kësaj urrejtjeje gjen madje, dhe në qëndrimet antikapitaliste të disa lëvizjeve ekstremiste perëndimore. Do të ishte e gabuar të flitej për të majtë apo të djathtë. Në Japoninë e viteve 1930-të, dëshira për të hequr qafesh modernitetin perëndimor ishte po aq e fortë tek disa intelektualë marksistë, sa dhe tek qarqet ultranacionaliste të djathta. E njëjta prirje vihet re edhe sot.

Sigurisht, njerëz të ndryshëm mund të kenë arsye të ndryshme për të urreyer Perëndimin. Është thjeshtë e pamundur të fusësh në një thes armiqësinë që kanë ndaj "imperializmit amerikan" majtistët, me atë të islamistëve radikalë. Ndonëse të dyja grupet i bashkon urrejtja për fuqinë hegjemonike të Shteteve të Bashkuara në planin kulturor dhe ekonomik, kur vjen puna te objektivat, krahasimi do të ishte i kotë. Në të njëjtën mënyrë, poetët romantikë mund të ëndërrojnë për një Arkadi baritore dhe të përbuzin metropolet modernë të dhënë pas tregtisë, por kjo nuk do të thotë se ata kanë ndonjë gjë tjetër të përbashkët me grupet fetarë radikalë, të cilat kërkojnë vendosjen e mbretërisë së Zotit përmbi tokë. Janë të shumtë ata që kanë neveri për disa prej aspekteve të kulturës moderne perëndimore apo asaj amerikane, por kjo rrallëherë përkthehet në dhunë revolucionare. Simptomat s'janë interesante përveç rasteve kur ato kthehen në një sëmundje të vërtetë. S'ka shumë rëndësi nëse dikush s'e do kulturën popullore perëndimore, kapitalizmin global, politikën e jashtme amerikane, qytetet e mëdha, apo lirshmërinë seksuale; kur kjo kthehet në një arsye për t'i shpallur luftë Perëndimit, kjo sigurisht, është mjaft më shqetësuese.